



PROJEKTI

“LABORATORI
PER AKTIVITETE TE BIZNESIT”

Raport
Maj-nëntor 2014

Përgatitur nga
Laboratori për Aktiviteteve të Biznesit (LAB)

■ PËRMBAJTJA

<u>Përmbledhje ekzekutive</u>	<u>3</u>
<u>Parathënie</u>	<u>5</u>
<u>Aktivitetet për t'i arritur objektivat e programit</u>	<u>7</u>
<u>Objektivat</u>	<u>8</u>
<u>Zhvillimet</u>	<u>9</u>
<u>Konkluzionet</u>	<u>12</u>
<u>Rekomandimet</u>	<u>13</u>
<u>Shtojcat</u>	<u>14</u>

■ PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të OJQ-së “Laboratori për Aktivitete të Biznesit - Lab” gjatë kësaj periudhe raportuese:

- Hani i Elezit është zonë që vuan nga normat e larta të papunësisë dhe të varfërisë që variojnë prej 70% dhe 50%.
- Projekti është parashikuar nga drejtuesit e “Sharrcemit”, në bazë të studimeve të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare, për të krijuar aktivitet të ri ekonomik dhe punësimin në këtë zonë.
- Sektori i Agrobiznesit është identifikuar si sektor me mundësi për rritje dhe zhvillim.
- Akterë të shumtë lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë u ftuan të marrin pjesë.
- Bordi i Drejtorëve është formuar në përbërje të palëve të interesuara lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare nga sektorët privatë, publikë dhe të OJQ-ve. ([shih Shtojcën 3](#))
- Krahu Këshillimor i IFC-së u angazhua për të hartuar mekanizmat e qeverisjes. ([shih Shtojcën 2](#))
- “Sharrcemi” ka kontribuar dhe vazhdon të mbështesë plotësisht projektin LAB, duke i kushtuar kohë dhe ekspertizë dhe duke ofruar mbështetje administrative dhe logjistike nëpërmjet ekipit të tij të CSR, si dhe individë nga menaxhmenti.
- Komuna e Hanit të Elezit ka ofruar mbështetje në të gjitha fushat e nevojshme që të krijojë një bashkëpunim të ngushtë me LAB-in dhe “Sharrcemin”, e cila ka forcuar marrëdhëniet ndërmjet tri palëve.
- Forumi për angazhim me hisedarë u organizua për të paraqitur objektivat e “Sharrcemit” për krijimin e OJQ-së LAB që do të ofrojë mundësi për zhvillim ekonomik dhe punësim për qytetarët e Hanit të Elezit.
- Ftesë publike për aplikimet në LAB për trajnimin dhe për fillimin e investimeve në fruta të buta, kultivim të perimeve me serrë, bletari dhe prodhimin e kërpudhave.
- Zhvillimi i formularit të aplikimit dhe udhëzimi për plotësimin e formularit të aplikimit, si dhe përcaktimi i kriterëve për sektorët e zgjedhur.
- Gjithsej 71 individë treguan interes për të aplikuar.
- Gjithsej 23 individë aplikuan për të marrë pjesë.
- Prej 23 fermerëve që kanë aplikuar, 19 aplikime janë aprovuar.
- LAB nënshkroi dy kontrata, njëren me Inicativën për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IZHBK) dhe tjetrën me “Kolegjin Perrotis dhe Shkollën e Bujqësisë Amerikane” për ekzekutimin e aktiviteteve të projektit LAB dhe për sigurimin e shërbimeve teknike dhe këshilluese. ([Shih Shtojcën 6](#))
- U zhvilluan të gjitha format e nevojshme të prokurimit me logon e LAB-it, në mënyrë që të përmirësohet dukshmëria e projektit.
- U vizituan 23 individë të cilët kanë aplikuar për mbështetje.
- Përzgjedhja e përfituesve u bë në bazë të pikëve të shënuara të zhvilluara për të gjithë sektorët.

- Publikimi i listës së përfituesve.
- Në varësi të fazës së zbatimit, brenda sektorit përkatës, trajnimi është siguruar për të gjithë 19 fermerët.
- Bordi i Drejtorëve të LAB-it ka mbajtur pesë takime, temat kryesore të diskutimit ishin planifikimi i objektivave të LAB-it, zhvillimet, zbatimi, kërkesat e financimit, personeli dhe vendime të tjera të rëndësishme që do të mbështesnin arritjen e objektivave të planifikuara për vitin 2014. ([Shih Shtojcën 3](#))
- U nënshkrua marrëveshja për dhurimin e fondeve. Fondacioni i kërkuar është vlerësuar me një grant prej 121.100,00 €, që përfaqëson 90% të investimit, me një pjesëmarrje prej 10% nga përfituesit, e cila arrin shumën prej 12.110,00 €, duke krijuar një buxhet të përgjithshëm prej 133.100,00 € për vitin 2014.
- Aktivitetet paralele përfshijnë nënshkrimin e një memorandumi mirëkuptimi me Komunën e Hanit të Elezit për të ofruar trajnime dhe kurse për qytetarët e Hani të Elezit, sidomos për nxënësit e shkollave fillore dhe të atyre të mesme. Kurse në IT-ja - aftësim në anglisht, produkte të Microsoft Office, etj., që do të ofrohen falas për të gjitha palët e interesuara.
- Bashkëpunëtori i “Sharrcemit”, “Baker Tilly Kosova”, nëpërmjet kontributit të tij të CSR ofroi shërbime të konsulencës në biznes pa pagesë për fermerët, i trajnuan ata në regjistrimin e biznesit dhe në menaxhimin financiar dhe ofruan trajnime dhe shërbime të konsulencës në bazë të nevojave të përfituesve edhe në të ardhmen.

■ PARATHËNIE

Projekti “Laboratori për Aktivitete Të Biznesit - LAB” synon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Hanit të Elezit nëpërmjet përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore agropjore të zonës në përputhje me strategjinë e CSR të Grupit Titan.

Papunësia ende mbetet një nga problemet më të mëdha për shumicën e banorëve në Hanit të Elezit, veçanërisht për fermerët në zonat rurale. Meqenëse sektori i agropjlltarisë mbetet sektori më premtues për rritjen dhe krijimin e vendeve të punës në Kosovë, fokus i angazhimit të laboratorit do të jetë mbështetja e sektorëve potencialë të agrobiznesit që do të lehtësojë dhe gjenerojë të ardhura dhe punësim të ri.

Projekti do të mbështesë financiarisht bizneset fillestare, me vëmendje të veçantë në përmirësimin e njohurive dhe aftësive në pjesën teorike dhe praktike, si dhe zhvillimin e bizneseve të reja dhe menaxhimin me efektivitet të kultivimit të llojeve të reja prodhuese bujqësore për të kënaqur kërkesat e tregut.

Rezultatet e pritura nga ky projekt janë nxitja e sipërmarrjes në sektorin e agrobiznesit, me qëllim të krijimit të aktiviteteve të reja ekonomike (NVM) që do të gjenerojnë të ardhura dhe zvogëlimin e papunësisë dhe përmirësimin e situatës socio-ekonomike aktualisht të vështirë në Komunën e Hanit të Elezit.

Për të siguruar transparencë të plotë dhe gjithëpërfshirje, hisedarë lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë u ftuan të marrin pjesë në projekt. Menaxhmenti i “Sharrcemit” organizoi takime bilaterale dhe multilaterale për të paraqitur projektin dhe i ftoi ata që të përfshihen. Rezultat i këtyre takimeve ishte krijimi i një organi të qeverisjes gjithëpërfshirëse, Bordi i Drejtorëve ([shih Shtojcën 2](#)), i cili përfshin përfaqësues nga sektorët publikë, privatë dhe të OJQ-ve.

Në frymën e qeverisjes së mirë dhe transparencës Divizioni Këshillues i IFC-së u angazhua për të zhvilluar strukturën e Qeverisjes së LAB-it. IFC-ja përfundoi një Vlerësim të qeverisjes së korporatave duke intervistuar të gjithë individët e përfshirë në zhvillimin e LAB-it, për të siguruar një plan funksional të qeverisjes që do t’i përmbushë të gjitha nevojat e foshnjës. Një Plan gjithëpërfshirës për zbatimin e qeverisjes u dha nga IFC-ja në qershor të vitit 2013 dhe është përdorur si një propozim për zhvillimin e strukturës së qeverisjes së LAB-it ([shih Shtojcën 2](#)).

KËSHILLIME TEKNIKE DHE KONSULENCË KORPORATIVE

Në mënyrë që të sigurohen aplikimi dhe zbatimi më i mirë i mundshëm i projekteve, Bordi dhe Menaxhmenti i LAB-it kanë vendosur që të angazhojnë institucione me reputacion kombëtar dhe ndërkombëtar që punojnë në fushën e trajnimit dhe zhvillimit të bujqësisë. Si të tilla janë identifikuar dy institucione si më të kualifikuarat dhe më mirë të përgatitura për t'i kryer këto detyra. ([Shih Shtojcën 6](#)).

Në Kosovë, IZHBK -ja (Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës) u punësua që të bëjë aftësimin praktik dhe teorik të fermerëve si dhe strukturën administrative të operacioneve të LAB-it për të siguruar përputhjen me standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për të siguruar ekspertizë edhe më të madhe AFS-ja (Shkolla e Bujqësisë Amerikane dhe Kolegji Perrotis në Selanik) është angazhuar për shërbime të mëtejshme të këshillimit dhe konsulencës për arsimimin në bujqësi dhe agrobiznes dhe zhvillimin e ndërmarrësisë në bujqësi. IZHBK -ja është organizatë e themeluar në vitin 2004 me seli në Mitrovicë, cila nëpërmjet aktiviteteve të saj angazhohet për zhvillimin rural, krijimin e kushteve më të mira socio-ekonomike në viset rurale, zvogëlimin e papunësisë dhe importit, prodhimin e ushqimit të shëndetshëm, shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe mbrojtjen e ambientit në Kosovë. IZHBK -ja është e certifikuar me standardet ISO 9001: 2008 dhe HACCP. IZHBK -ja ka një infrastrukturë të brendshme prej 1.000 m² me një staf profesional të përbërë nga 20 persona me prejardhje të ndryshme në bujqësi dhe në ekonomi.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet IZHBK -së dhe LAB-it, nën numrin e kontratës 1/14, datë 07.22.2014, janë kryer shërbime të prokurimit, administratës dhe financave, si dhe trajnime teknike dhe praktike në hortikulturë dhe në bujqësi.

Shkolla e Bujqësisë Amerikane nga Selaniku, Greqi, është institucion i pavarur, jofitimprurës e arsimor i themeluar në vitin 1904 për t'u shërbyer nevojave të Greqisë dhe zonës së Ballkanit përreth. Sot divizionet kryesore arsimore përfshijnë shkollën fillore, shkollën e mesme, Kolegjin Perrotis të Bujqësisë, të Mjedisit, të Shkencave të jetës, dhe Hulumtim dhe Arsimim për të rritur. Shkolla përgatit të diplomuarit e saj për rolet e rëndësishme në jetën e komunitetit dhe në sektorët e bujqësisë dhe të ushqimit, duke ofruar mësim në praktikat bujqësore dhe të biznesit që janë ekonomikisht të qëndrueshme, ekologjikisht të shëndetshme dhe me përgjegjësi shoqërore.

Themeluesi i Shkollës, Dr. John Henry House, ishte një idealist praktik, i cili besonte në edukimin e plotë të individit: kokën, duart dhe zemrën. Pas më shumë se një shekulli të zbatimit të vizionit të themeluesit, sot Shkolla e Bujqësisë Amerikane mbetet e përkushtuar për bashkim dinamik të teorisë dhe praktikës në të gjitha nivelet e arsimit bujqësor, që është bërë shenjë dalluese e institucionit.

Shkolla Bujqësore (AFS) u shërben studentëve në nivel të mesëm, pas shkollës së mesme dhe të rriturve. AFS-ja ofron arsimim formal në bujqësi, si dhe trajnime teknike dhe profesionale. Ajo përpiqet të përgatisë studentët për rolet e lidershit në jetën e komunitetit dhe të nxisë nisma individuale, frymën e ndërmarrësisë, vlerësimin e përsosmërisë, një qëndrim të përherëshëm për kërkim të informacioneve dhe aftësinë për të bashkëpunuar.

■ AKTIVITETET PËR TË ARRITUR OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

Raporti mbulon aktivitetet kryesore të kryera gjatë periudhës kohore 1 maj deri 30 nëntor 2014 në zbatimin e Projektit LAB siç është propozuar nga Menaxheri i Përgjithshëm dhe miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

Prezantimi dhe objektivat për krijimin e OJQ-së, Laboratori për Aktivitetet të Biznesit (LAB) dhe zbatimi i projekteve të saj janë paraqitur në forumin lokal për angazhim me hisedarë. [\(Shih Shtojcën 4\).](#)

Për hir të transparencës, janë organizuar takime shtesë multilaterale dhe bilaterale me grupe të ndryshme të interesuara, në mënyrë që të promovohen objektivat e programit dhe idetë e ngritura nga pjesëmarrësit gjatë prezantimit.

Në mënyrë që të kuptojmë më mirë sektorët potencialë për të investuar në biznese fillestare, fillimisht janë shqyrtuar studime të ndryshme, është zhvilluar një vlerësim paraprak në fushën e potencialeve ekzistuese në sektorin e agropylltarisë, gjithashtu është iniciuar një vizitë studimore në Qendrën për Ndërmarrësi në Shkollën e Bujqësisë Amerikane.

Duke u bazuar në gjetjet nga vlerësimi paraprak, u prezantuan rrjedhja e parasë dhe llogaritja e fitimit me ndikimet e mundshme në sektorët e synuar. Plani gjithëpërfshirës me rekomandime për sektorët potencialë nga perspektiva e mbështetjes së bizneseve fillestare nëpërmjet investimeve është paraqitur dhe aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 6 qershor 2014. [\(Shih Shtojcën 3\).](#)

Duke pasur parasysh vlerësimin dhe duke marrë parasysh objektivat e të ardhurave dhe kthimit në kapital, sektorët e mposhtëm janë zgjedhur për mbështetje për periudhën kohore prej një viti:

- Kultivimi i frutave të vogla (dredhëzave, mjedra)
- Kultivimi serrë
- Bletaria
- Kultivimi i kërpudhave

[\(Shih Shtojcën 5\)](#)

Projekti ka parashikuar investimin në krijimin e 19 ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme në Komunën e Hanit të Elezit.

[Foto 1 Puna në zyrat e LAB-it](#)

OBJEKTIVI

Qëllimi i themelimit të Fondacionit nga "Sharrcepi" është që të sigurojë mbështetje alternative për të ardhurat dhe mundësitë për angazhim ekonomik dhe punësim për banorët e Hanit të Elezit nëpërmjet:

- Mbështetjes në krijimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të reja ekonomike që janë të domosdoshme për të siguruar ndikim të shpejtë në krijimin e të ardhurave;
- Sigurimit të mundësive të punësimit për banorët e Komunës së Hanit të Elezit;
- Edukimit, trajnimit dhe zhvillimit të aftësive, sidomos për njerëzit që jetojnë në zonat rurale për të maksimizuar shfrytëzimin e potencialeve në blegtori, kultivimin e serrës, kultivimin e frutave të vogla dhe manaferrave, bletari, kultivimin e kërpudhave, mbledhjen e frutave të egra pyjore dhe mirëmbajtjen e pyjeve;
- Krijimit të një ndjenje të një ndryshimi pozitiv që nëpërmjet krijimit të biznesit të tyre fermerët do të sigurojnë vetëpunësim dhe të ardhura të mjaftueshme për nevojat e familjes dhe për zgjerimin e bizneseve të tyre fillestare;
- Rritjes së eksperiencës dhe kapaciteteve në dispozicion në LAB, duke angazhuar për një periudhë të caktuar kohore, organizatat (IZHBK - Vushtrri) me përvoja të avancuara teknike në sektorin e agrobizneseve, si dhe Institucionin e Edukimit dhe Hulumtimit (AFIS - Greqi, Selanik) për mbështetje me këshillime dhe hulumtime. ([Shih Shtojcën 6](#))

ZHVILLIMET

Metodologjia

Metodologjia e punës që përdoret për të arritur qëllimin e objektivave të projektit është e bazuar në një plan të punës që i aplikon metodat e punës të cilat përdoren nga IZHBK -u për të kryer aktivitete të ngjashme.

Momenti historik 1. Zhvillimi i formave

Statusi: I kompletuar

Të gjitha format e nevojshme të prokurimit dhe ato administrative dhe dokumentet e tjera janë përgatitur me logon e LAB-it për të përmirësuar dukshmërinë e projektit.

Momenti historik 2. Përzgjedhja e fermerëve / përfituesve

Statusi: I kompletuar

Përzgjedhja e fermerëve të LAB-it është bërë me pjesëmarrjen e IZHBK -ut, përfaqësuesve të LAB-it dhe të Komunës së Hanit të Elezit. Kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në bazë të listës së pikëve të shënuara në të cilën përfshihen: përbërja familjare, distanca nga banimi, toka dhe pjerrtësia e tokës, pozita e tokës, furnizimin me ujë, gjendja financiare dhe përvoja. Bazuar në këto kritere Komisioni ka caktuar pikët dhe ka zgjedhur 19 përfitues, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara, nga gjithsej 23 sa kanë aplikuar.

Momenti historik 3. Përpunimi i tenderit

Statusi: Në proces

Për pesë tenderë të gjitha rregullat e zbatueshme të IZHBK -ut janë zbatuar në përputhje me aktivitetet e sektorit. Një dosje e tenderit është përgatitur nga zyrtarë, inxhinierë të prokurimit të Hortikulturës në konsultim me LAB-in. Shpalljet e tenderit në gazetë dhe procedurat vijuese janë bërë nga LAB-i në përputhje me kërkesat e miratuara. Zyrtari i prokurimit i IZHBK -ut ka qenë pjesë e Komisionit në hapjen ofertave për veprimtaritë e mëposhtme:

1. Furnizim me fidanë të dredhëzave dhe inpute të tjera të ngjashme
2. Furnizim me fidanë të mjedrës dhe inpute të tjera të ngjashme
3. Furnizim me sera, fara, fidanë dhe inpute të tjera të ngjashme
4. Furnizim me substrate të rritjes për kultivimin e kërpudhave, pajisje dhe inpute të tjera të ngjashme (në proces)
5. Furnizim me bletët dhe inpute të tjera të ngjashme (në proces).

Momenti historik 4. Trajnimi

Statusi: Në proces

Gjatë kësaj periudhe, për përfituesit e dredhëzës, mjedrës, serrave dhe bletarisë janë organizuar sesione të ndryshme trajnuese, në varësi të aktiviteteve të zhvillimit për secilin sektor. Trajnimi teorik dhe praktik ka filluar pas nënshkrimit të kontratave me 15 përfituesit dhe pas rregullimit të pagesës së 10% të bashkinvestuesit / kontributi në koston e përgjithshme të investimit. Trajnimet teorike dhe praktike janë mbajtur nga inxhinierët e Hortikulturës nga IZHBK -u.

Trajnimi teorik për fermerët u mbajt në zyrat e LAB-it, ndërsa kurset e trajnimit praktik janë organizuar drejtpërdrejt në fushë për përfituesit. Sesionet e trajnimit për përfituesit e dredhëzave u organizuan në temat e mëposhtme:

1. Puna përgatitore për krijimin e pemishtes me dredhëza;
2. Përgatitja e shtretërve, mbulesave të zeza dhe sistemit të ujitjes;
3. Përgatitja e materialit fidanor për mbjellje dhe mbjellja.

Për përfituesit e mjedrës sesionet e trajnimit teorik dhe praktik u organizuan në temat e njëjta:

1. Puna përgatitore për krijimin e pemishtes me mjedër;
2. Përgatitja e shtretërve, mbulesave të zeza dhe sistemit të ujitjes;
3. Përgatitja e materialit fidanor për mbjellje dhe mbjellja

Duke marrë parasysh zhvillimet në serra dhe bletari, trajnimi për të dy përfituesit është organizuar në vetëm një sesion:

1. Përgatitja e serrës për mbjelljen e perimeve në vjeshtë, ndërsa sezoni i trajnimit në bletari është organizuar me temë:
2. Informacion i përgjithshëm mbi kultivimin e bletëve.

Momenti historik 5. Implementimi

Statusi: Në proces

Puna zbatuese e këtij sezoni për krijimin e 0,6 hektarëve me pemishte me dredhëza dhe 0,4 hektarëve me mjedër është përfunduar me sukses, ndërsa zhvillimet për serra janë në fazën e përfundimit të ndërtimit të serrave. Sektori i bletarisë dhe kultivimi i kërpudha janë në proces të tenderimit. Furnizimi me bletë, adaptimi i pajisjeve dhe kërpudhat dhe inputet e tjera të ngjashme janë planifikuar të përfundojnë në fund shkurtit të 2015.

Momenti historik 6. Rekrutimi i stafit

Statusi: I kompletuar

Procesi i rekrutimit për stafin në laborator është përfunduar për pozitën e Zyrtarit të financave dhe Asistentit administrativ. Për të dy pozitat është zhvilluar nga një test, dhe janë ftuar që t'i nënshtrohen testit 9 kandidatët për pozitën e Zyrtarit të financave dhe 4 kandidatë për Asistent administrativ. Bazuar në rezultatet e testit, kandidatët me mbi 80 pikë janë ftuar për intervistë. Për të dy pozita tre kandidatë kanë arritur pikët e duhura. Në këtë proces një menaxher i financave dhe një asistent administrativ janë ftuar për intervistë dhe të dy i kanë plotësuar kriteret dhe janë zgjedhur me sukses për pozitën që ata kanë aplikuar.

■ KONKLUZIONET

Konkluzionet dhe rezultatet që mund të nxirren nga kjo periudhë raportuese janë si vijojnë;

- **PREZANTIMI:** Prezantimi i objektivave të “Sharrcemit” për të siguruar të ardhura alternative dhe mundësi për zhvillim ekonomik dhe punësim për banorët e Hanit të Elezit nëpërmjet krijimit të OJQ-së LAB dhe konsultimi me hisedarë të ndryshëm u zhvillua me sukses.
- **TRANSPARENCA:** Të gjitha komentet nga mbledhjet me palët e interesuara dhe vizitat në terren me fermerët individualë, me Qeverinë dhe institucionet komunale u shqyrtuan nga Bordi i Drejtorëve të cilët u pajtuan që të përfshihen në sektorët që do të mbështeten.
- **BASHKËPUNIMI:** Të gjitha trajnimet e ofruara nga IZHBK kanë reflektuar pozitivisht në përmirësimin e njohurive të përgjithshme në lidhje me fillimin e bizneseve të reja, veçanërisht në fushat që ata do të jenë të angazhuar.
- **PROCESET:** Të gjitha aktivitetet që lidhen me përgatitjen e dosjes së tenderit, me procedurat e prokurimit, të metodologjisë së vlerësimit etj. janë përpunuar në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarë të prokurimit të IZHBK -ut në formë të standardeve në transparencë të plotë dhe në pajtueshmëri me ligjet në fuqi.
- **PAJTUESHMËRIA:** Duke aplikuar këtë lloj të sistemit të punës, kemi krijuar një mjedis shumë mbështetës nga të gjitha palët e interesuara për zbatimin e objektivave të planifikuara për vitin e parë në një mënyrë plotësisht transparente dhe në përputhje të cilat janë realizuar me shumë sukses.


■ HAPAT E MËTEJSHËM – REKOMANDIMET

- Të vazhdohet me formën aktuale të angazhimit. Është e qartë në raport se projekti është duke shkuar në një drejtim që do të sigurojë rezultate të cilësisë dhe të ngritjes së vetëdijes për të krijuar një kulturë sipërmarrëse në komunitet, dhe në të njëjtën kohë zhvillimin e një sektori që është injoruar në masë të madhe nga qytetarët e Komunës.
- Të zgjerohen sektorët për të përfshirë prodhimin dhe përpunimin e qumështit, prodhimin e mishit të pulave, bimëve mjekësore, hollimi i pyjeve për të mbledhur materiale për ngrohje dhe qëllime të tjera, etj.
- Të vazhdohet monitorimi dhe udhëzimi për përfituesit ekzistues me programet teknike dhe praktike të trajnimit, si dhe konsultime të biznesit për të siguruar suksesin dhe rritjen e vazhdueshme, dhe për të maksimizuar numrin e vendeve të reja të punës në komunitet.
- Të mbështeten përfituesit / fermerët në krijimin e kontakteve tregtare me blerësit lokalë dhe ndërkombëtarë për produktet e tyre.
- Të krijohet një qendër grumbullimi për ruajtje të ftohtë në qytetin e Hanit të Elezit që të mund të shërbejë si një pikë e shitjes për produktet e prodhuara nga bizneset përfituese.
- Të vazhdohet bashkëpunimi i ngushtë me IZHBK -në dhe me Shkollën e Bujqësisë Amerikane në zhvillimin e programeve dhe projekteve të mëtejshme për përfituesit e ardhshëm.
- Të vazhdohet puna me hisedarë vendorë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të gjetur burime të reja të financimit për të zhvilluar projektin sa më shumë të jetë e mundur.

SHTOJCA 1.

Regjistrimi dhe administrimi i LAB-it

- **Forma ligjore:** Organizatë joqeveritare (OJQ), e themeluar si një shoqatë jofitimprurëse në bazë të Ligjit nr. 0411-57, seksioni 9 për Lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.
- **Numri i regjistrimit/ Numri i biznesit:** 5114875-4, i lëshuar nga Ministria e Administratës Publike.
- **Data e Regjistrimit:** 13.02.2014.
- **Numri Fiskal:** 601130959.
- **Qasje në llogarinë bankare:**
 1. Emmanuel Mitsou, arkëtar i Bordit të Drejtorëve, "Sharrcem".
 2. Ylber Burgjia, sekretari i përgjithshëm i Bordit të Drejtorëve, "Sharrcem".
 3. Hysen Shabanaj, drejtor i përgjithshëm i LAB-it.
- Dy nënshkrime kërkohej për blerjet mbi 100 euro.



■ SHTOJCA 2.

Bashkëpunimi qeverisës me IFC-në

- Në frymën e qeverisjes së mirë dhe transparencës, Krahu Këshillues i IFC-së ishte i angazhuar për të zhvilluar struktura drejtuese të LAB-it.
- Zyra Këshillëdhënëse e IFC-së në Shkup përfundoi një Vlerësim të qeverisjes së korporatave, duke intervistuar të gjithë individët e përfshirë në zhvillimin e LAB-it për të hartuar kështu një plan funksional të qeverisjes që siguron përmbushjen e të gjitha nevojave të laboratorit në mënyrën më të mirë.
- Një Plan gjithëpërfshirës i zbatimit të qeverisjes u dha nga IFC-ja në qershor të vitit 2013.

Qeverisja e Organizatës

- **Forma ligjore:** Organizatë joqeveritare (OJQ), e themeluar si një shoqatë jofitimprurëse. Organet: Kuvendi i anëtarëve (organ më i lartë drejtues), Bordi i Drejtorëve, Këshilli i Hisedarëve, komitete të tjera / grupe pune etj.

Kuvendi kontrollon anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe aktivitetet e tyre nëpërmjet: zgjedhjes / heqjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve; Miratimit të aktiviteteve të Bordit të drejtorëve (p.sh. raporti vjetor).
përbëhet nga "Sharrcem" Sh.P.K, material ndërtimor "Kosova LLC",
"Sharr Beteiligungs" GmbH.

- **Objektivi:** "Lehtësimi i gjenerimit të punësimit të ri në Komunën e Hanit të Elezit nëpërmjet aktiviteteve për promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve)".
- **Anëtarësia:** Të hapur për çdo person. Zgjedhja me shumicën anëtarëve ekzistues të Kuvendit.
- **Rregulloret:** Kuvendi i Themeluesve qeveriset sipas akteve nënligjore të hartuara dhe të miratuara në bashkëpunim me IFC-në, si dhe këshilltarë vendorë dhe nga Zyra Qendrore e "Titan / Sharrcem".
- **Vendimet e mëdha:** kërkohet 2/3 e shumicës (heqjen e anëtarëve të kuvendit, ndryshimin e aktit themelues, shpërndarjen).
- **Shpërndarja:** Kërkesa në bazë të ligjeve të Kosovës - "Kur të vendoset për shpërbërjen e Shoqatës, Kuvendi do të përcaktojë shoqatën ose fondacionin ku do të destinohen asetet e mbetura, pasi që Shoqata të shpërndahet. Shoqata ose fondacioni i zgjedhur duhet të ketë qëllime të njëjta ose të ngjashme me të organizatës".

Bordi i Drejtorëve

- **Anëtarësia:** Emërohet dhe zgjidhet nga deputetët e Kuvendit të Themeluesve:
Seksioni 2.1. Zgjedhja nga Kuvendi. Anëtarët e Kuvendit zgjedhin anëtarët e Bordit të

Drejtorëve.

- **Rregulloret:** Bordi i drejtorëve qeveriset në bazë të akteve nënligjore të hartuara dhe të miratuara në bashkëpunim me IFC-në, si dhe me këshilltarë vendorë dhe nga Zyra qendrore e “Titan / Sharrcem”.
- **Vendime të mëdha:** Kërkohet 2/3 e shumicës dhe preferohet unanimitet.
- **Raportimi:** Bordi i Drejtorëve raporton te Kuvendi i Themeluesve, i cili është organi më i lartë drejtues i Shoqatës.

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve:

1. Kryetar: Halit Hoxhaj, këshilltar politik në Ministrinë e Bujqësisë dhe Planifikimit Rural, 10 vjet përvojë relevante.
2. Arkëtar: Emmanuel Mitsou, drejtor menaxhues, “Sharrcem”.
3. Sekretari i përgjithshëm: Ylber Burgija, zyrtar për marrëdhënie me jashtë, “Sharrcem”.
4. Mark Wood, mundësi të reja për bujqësi në Kosovë, shefi i Partisë, bachelor i shkencave në bujqësi, 30 vjet përvojë relevante.
5. Heini Conrad, HELVETAS Swiss Inter-cooperation, menaxher i vendit për Kosovë, bachelor i shkencave në ekonomi, 29 vjet përvojë relevante.
6. Fatos Krasniqi, “Raiffeisen Bank Kosovo”, drejtor i Departamentit të Bizneseve të Vogla në “Raiffeisen Bank” në Kosovë, bachelor i shkencave në ekonomi, 15 vjet përvojë relevante.
7. Ali Axhami, Komuna e Hanit të Elezit.

Këshilli i Hisedarëve:

- **Propozuar nga IFC-ja:** Me qëllim të mbajtjes së transparencës në nivel më të lartë, si dhe të sigurimit maksimal të kontributit shkencor dhe këshillues.
- **Përbërja:** Të jetë i përbërë nga hisedarë të rëndësishëm kombëtarë dhe ndërkom-bëtarë.
- **Themelimi:** Bordi i Drejtorëve, në bashkëpunim me Kuvendin e Themeluesve, të përgatitë dhe të dërgojë ftesa për pjesëmarrje.

Partneritetet e Këshilluesve Shkencorë:

- Shkolla e Bujqësisë Amerikane dhe Kolegji Perrotis, Selanik, Greqi.
- IZHBK -u (Iniciativa për zhvillimin e bujqësisë në Kosovë).

Partneriteti i Këshilluesve financiarë:

- “Baker Tilly Kosovo”, në baza vullnetare, si kontribut ndaj Përgjegjësisë Shoqërore Korporatave (CSR).

■ SHTOJCA 3.

Bordi i Drejtorëve

- Me qëllim të gjithëpërfshirjes dhe transparencës është paraparë që LAB-i të qeveriset në bashkëpunim me hisedarët më të rëndësishëm lokalë dhe kombëtarë.
- U formua Bordi i Drejtorëve i përbërë nga institucione të tilla që përfshin përfaqësues nga sektorët publikë, privatë dhe të OJQ-ve.
- Anëtarët e Bordit të Drejtorëve u ftuan të marrin pjesë në takimet bilaterale dhe multilaterale ndërmjet përfaqësuesve të “Sharrcemit” dhe organizatave të tyre.
- Bordi i Drejtorëve përfshin përfaqësues nga Komuna e Hanit të Elezit, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, “Helvetas Swiss Inter-cooperation”, “Mundësi të reja për bujqësisë në Kosovë” (një projekt i USAID-it), “Raiffeisen Bank” në Kosovë, “Sharrcem” dhe “Sharr Beteligungs”.

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve:

1. Kryetar: Halit Hoxhaj, këshilltar politik në Ministrinë e Bujqësisë dhe Planifikimit Rural, 10 vjet përvojë relevante.
2. Arkëtar: Emmanuel Mitsou, drejtor menaxhues, “Sharrcem”.
3. Sekretari i përgjithshëm: Ylber Burgija, zyrtar për marrëdhënie me jashtë, “Sharrcem”.
4. Mark Wood, mundësi të reja për bujqësi në Kosovë, shefi i Partisë, bachelor i shkencave në bujqësi, 30 vjet përvojë relevante.
5. Heini Conrad, HELVETAS Swiss Inter-cooperation, menaxher i vendit për Kosovë, bachelor i shkencave në ekonomi, 29 vjet përvojë relevante.
6. Fatos Krasniqi, “Raiffeisen Bank Kosovo”, drejtor i Departamentit të Bizneseve të Vogla në “Raiffeisen Bank” në Kosovë, bachelor i shkencave në ekonomi, 15 vjet përvojë relevante.
7. Ali Axhami, Komuna e Hanit të Elezit.

Takimet e Bordit të Drejtorëve të LAB-it

- **11 shkurt 2014**
 - Fjalimet e mirëseardhjes, të rejat mbi procesin e regjistrimit.
 - Propozimet e menaxherit të përgjithshëm, përcaktimi i procesit të punësimit.
 - Metodatat e marrjes së vendimeve nga Bordi i Drejtorëve.
 - Aranzhimi i takimit të ardhshëm.

- **27 mars 2014**
 - Formimi i Komisionit për Punësimin e menaxherit të përgjithshëm: Heini Conrad, Mark Wood, Halit Hoxaj.
 - Shqyrtimi i propozimeve për qeverisje nga IFC-ja.
 - Përzgjedhja e anëtarëve të titulluar anëtarët e Bordit të Drejtorëve: Halit Hoxhaj, kryetar, Ylber Burgjia, sekretar i përgjithshëm, Emmanuel Mitsou, arkëtar.
- **6 qershor 2014**
 - Prezantimi i menaxherit të përgjithshëm, z. Hysen Shabanaj.
 - Prezantim i projekteve nga menaxheri i përgjithshëm te Bordit i Drejtorëve.
 - Konferenca përmes videos me Shkollën e Bujqësisë Amerikane.
 - Diskutimi mbi qeverisjen e korporatës.
- **31 korrik 2014**
 - Përditësimi i projekteve të menaxherit të përgjithshëm.
 - Hapat e mëtutjeshëm, lista e aktiviteteve për t'u realizuar.
 - Metodatat e Bordit të Drejtorëve për vendimet, me shkrim, me email, personalisht.
- **2 shtator, 2014**
 - Angazhimi i AFS-së, të iniciohet nga Bordi i Drejtorëve në bazë të nevojës.
 - Angazhimi i IZHBK -ut, puna e bërë deri më tani.
 - Prezantimi i përfituesve.
 - Themelimi i Procesit të Prokurimit në bazë të standardeve të BE-së.

Përzgjedhja dhe punësimi i menaxherit të përgjithshëm

Duke vazhduar në frymën e qeverisjes transparente, Bordi i Drejtorëve formoi një komision, duke i dhënë detyrën e punësimit të menaxherit të përgjithshëm për LAB-in.

Për të siguruar një mision të qartë u hartuan termat e referencës në bazë të propozimeve të IFC-së.

Pas shpalljes publike u pranuan dhe u shqyrtuan 26 rezyme, nga të cilat 4 kandidatët kryesorë ishin zgjedhur dhe intervistuar.

Në bazë të një procesi të detajuar të pikëve të shënuara, komisioni në mënyrë të pavarur vlerësoi kandidatët.

Kandidati me rezultatin më të lartë kumulativ u punësua për pozitën.

Në pikët e shënuara u përfshinë kategori të tilla si: arsimi përkatës, përvoja, etj.

**CURRICULUM
VITAE**

**MENAXHERI I
PËRGJITHSHËM**

SHTOJCA 4.

23/2014/CSR

Angazimi i hisedareve

Facts

Sharrcem

FORUMI I PARË ME HISEDARË NË HANI TË ELEZIT- 28.10.2013

"Sharrcem" ka organizuar një ngjarje për hisedarë lokalë, të mbajtur nga kryesuesi i Komitetit për CSR, z. Enver Curti, i përkrahur nga anëtarët e Task Forcës për CSR. Ngjarja është organizuar në Qendrën e Kulturës të Komunës dhe është vëzhguar nga kryetari i Komunës, z. Refik Suma, dhe nga zyrtarë të tjerë të kësaj të Komunitetit dhe qytetarë të tjerë.

Task Forca për CSR e "Sharrcemit" prezantoi raportin e kompanisë për CSR të vitit 2012 dhe aktivitetet e vitit 2013 deri në atë datë, ndërsa drejtori menaxhues i kompanisë dhe një pjesë e kësaj me planin e ardhshëm dhe identifikoi prioritetet për kontribut shoqëror. Bazaar në parafund të kryesuesit të Komitetit për CSR në kjo ngjarje ka për qëllim të vendosë transparencë përmes shoqërisë, falja jo dhe qytetarëve dhe një shkëmbim i frytshëm ideash dhe informata shpesh ndodhi, ishte hera e parë që një ngjarje e tillë ka ndodhur në komunitet dhe si rezultat zgjedhëmarijtë si gjënë të qytetarëve ngjarja u konsiderua si e suksesshme.



FORUMI I PARË ME HISEDARËT KYÇ- 29.01.2014, PRISHTINË

Forum i organizuar nga njëri CSR në Kosovë dhe Oda Ekonomike e Kosovës. Si pjesë të ngjarjes fabrika për prodhimin e çimento "Sharrcem", shpallori për herë të parë në Kosovë raportin më të përfunduar dhe praktikisht të orientuar drejtuesit dhe të Përfunduarit Shoqërore Korporative (CSR) të kompanisë. Dhe në këtë rast u ngjira se me themelimin e "Laboratorit për Aktivitete të Biznesit" (LAB), qëllim i Komitetit të Hani të Elezit do të përfillojë me krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në tushën e bujqësisë. Kjo ODI do të financohet nga "Sharrcem" dhe do të jetë një entitet i ndërtuar nga kompania dhe i mbledhur nga një bord i pavarur, si një shoqëri përfunduar.



13/2014/CSR

LAB

Facts


Sharrcem

LAB- LABORATORI PËR AKTIVITETE TË BIZNESIT

Rëndësar nga norma e larta të papunësisë dhe varfërisë, Hani i Elezit është një komunitet i cili mbledhet kryesisht në "Sharrcem" dhe në kontraktoret e tij për krijimin e vendeve të punës. Këto probleme janë përkrahës nga mungesa e fondeve të nevojshme për zhvillim komunal dhe në mungesë të një kornize të arsimit profesional.

Duke e kuptuar nevojën që zhvillimi i kompanisë të shoqërohet me zhvillimin e komunitetit ku operon, "Sharrcem" është angazhuar në zhvillimin e një projekti për të krijuar krijimin e ndërmarrjeve të reja, të vogla dhe të mesme në Hani të Elezit, me qëllim të krijimit të punësimit të ri dhe të të ardhurave për komunitetin.

Nëkohësisht, qëllimi "Sharrcemit" është krijimi i një zgjedhjeje afatgjatë dhe të qëndrueshme për problemin, duke lejuar komunitetin të shpallur nga varësia në aktivitetet e "Sharrcemit" dhe të bëhet i pavarur dhe i vetëqëndrueshëm, dhe në të njëjtën kohë zhvillimi i tokës bujqësore në dispozicion në këtë zonë.



Pris, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Komunitet e Hani të Elezit dhe ODI të ndërkombëtarë në vitin 2014 filloi "Laboratori për Aktivitete të Biznesit" LAB.

Me qëllim të edukimit të anëtarëve të komunitetit në ndërmarrje, LAB i synon krijimin e bizneseve të reja, të cilat do të mbledheshin ndërmjet programeve zhvilluese dhe monitoruese. Qëllimi është që, jo vetëm të krijohen biznese të reja, por edhe të ndërmohet të bëhen të qëndrueshme dhe të zhvillohen në mënyrë që të mos shpallë anëtarët të komunitetit të përfillojë prej tyre. Me qëllim të krijimit të vendeve të punës dhe uljes të varfërisë, LAB i ka për qëllim të jetë një kanal për zhvillimin ekonomik të Komunës dhe më gjërë.

SHTOJCA 5.

Objektivi:
për themelimin e Fondacionit nga Sharrcem sh.p.k

- Mbështetja në krijimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të reja ekonomike që janë të domosdoshme për zvogëlimin e papunësisë; përmirësimin e kushteve sociale në Komunën Hani i Elezit.
- Arsimimi, trajnimi dhe zhvillimi aftësive për popullsinë në zonat rurale për të optimizuar përdorimin e potencialit të blegtorisë dhe kultivimin e serrës, bletarisë, frutave të vogla, mbledhjen e frutave të malit, kultivimin dhe mirëmbajtjen e kërpudhave.

SHTOJCA 6.



MARRËVESHJE PËR KËSHILLIME TEKNIKE DHE SHËRBIME

KJO MARRËVESHJE ("Marrëveshja") është lidhur më 30 korrik 2014 ndërmjet **LAB**, dhe Shoqatës jo-fitimprurëse me zyrën e saj të regjistruar në Han të Elezit, Kosovë dhe përfaqësuar nga Menaxheri i Përgjithshëm z. Hyson Shabanaj dhe Arkitekti i Bordin të Drejtuesve z. Emmanuel Mitoua (në tekstin e mëtejshëm referuar si "Klienti"), dhe Shkolla Amerikane Bujqësore, Shoqata e Arsimit pa Shkollës së Mesme dhe Shoqata e Trajnimeve themeluar në Selanik, Greqi dhe përfaqësuar nga Dr. Panagiotis Kamolis, President (në tekstin e mëtejshëm referuar si "Perrotis College"), Klienti dhe Kolegji Perrotis së bashku në tekstin e mëtejshëm do të referohen si "Palët" dhe individualisht si "Pala"

NDËRSA Klienti është shoqatë jo fitimprurëse e cila ka si synim të financojë, mbështesë dhe mentorojë ndërmarrjet e reja private, me aktivitete në sektorin e Agro-Ushqimit në rajonin e Komandës së Hanit të Elezit në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm referuar si "Rajoni")

NDËRSA Perrotis College është një institucion i specializuar në sektorin e Agro-Ushqimit, në fushën e trajnimit, mbështetjes teknike, zhvillimit të aftësive, hulumtimit dhe inovacionit me përvojë të gjerë në kultivime dhe blegtori, me përvojë ndërkombëtare që ofron shërbime këshillimi dhe ndihmë për studime dhe zbatimin e projekteve bujqësore.

NDËRSA Klienti ka si synim të mundësojë financimin e hapjes së disa Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme me aktivitete ekskluzive në sektorin e Agro-Ushqimit në Rajonin përreth përfaqësuesit të qytetarëve lokal të cilët kanë nevojë për mbështetje teknike, organizative dhe zhvillim të aftësive me qëllim të sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ndërmarrjeve të sapo hapura

NDËRSA Perrotis College ka vullnetin të ofrojë ekspertizën e vet, përvojën, aftësitë sa i përket vlerësimit të kushteve dhe burimeve natyrore në dispozicion në Rajonin e mëtejshëm, trajnimit dhe mentorimit e fermerëve dhe duke përfshirë edhe kjoçejtën e shërbimeve sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në pajtim me termet dhe kushtet e saj.

TANI KJO MARRËVESHJE DËSHMON SI VLIJON:

- Klienti me këtë rast cakton Perrotis College të ofrojë shërbimet, raportet dhe shërbime tjera në përshkrimet në **Shtojcën 1** (në tekstin e mëtejshëm referuar si "Shërbimet") dhe Perrotis College me këtë rast pranon dhe pajtohet me caktimin e tij për të ofruar Shërbimet në pajtim me termet dhe kushtet që gjenden në këtë marrëveshje dhe me kujdes të plotë, përkatësisht dhe efiçentisht. Në mënyrë të shpejtë dhe të shpejtë të kësaj Marrëveshjeje i referohet dhe përfshirë vetëm Shërbimet. Raportet dhe shërbime tjera të ofruara Klientit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë pronë e, dhe do të përdoren limitshëm nga Klienti.
- Në vlerësimin e Shërbimeve të Perrotis College, Klienti do të paguajë një tarifë fikse ("Tarifë") prej **15,000.00 Eurove**. Tarifë do të paguhet sipas fakturave mujore që lëshohen për Perrotis College sipas vlerës së Shërbimeve të ofruara gjatë muajt paraprak. Perrotis College ka mundësinë dhe të drejtën të leshojë faktura çdo dy muaj në të cilin rast vlera e Shërbimeve të dy muajve paraprak dhe muajve vijues do të reflektohen. Shërbimet do të ofrohen në mënyrë ekskluzive sipas Kërkesës me shkrim për Shërbime të shërbuar nga Klienti dhe dërguar Perrotis College. Ky i fundit do të pranojë detyrën e Shërbimeve me nënshkrimin e Kërkesës për Shërbime përmbledhur më lart.
- Në rast se para përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, shumën e plotë të paragrafit 2 në lart është paguar për Perrotis College dhe Klienti ende i nevojiten Shërbime në vazhdim, Palët do të pajtohen me shkrim me anë të një aneksi të kësaj Marrëveshjeje, për një shumë shtesë për të anuluar tarifën plotësisht sipas nevojave të Klientit.



KONTRATË PËR SHËRBIME

Numër: 1/14

Ndërmjet

INICIATIVËS PËR ZHVILLIM BUIQËSOR NË KOSOVË

Me Zyrën e saj në

Fshatin Sfarçak i Ulët, p.n.

42 000 Vushtrri

Kosovë

NRF: 600186177

NRB: 80008473

TVSH: 330001305

Në tekstin e mëtejshëm referuar si "IZHBK"

Dhe

LABORATORIT PËR AKTIVITETE BIZNESORE

Në tekstin e mëtejshëm referuar si "LAB"

Me Zyrën e tij në

Rr. Adem Jashari p.n.

71510 Han i Elezit

Kosovë

NRF: 601130959

NRB: 5114875-4

TVSH: nuk ka

Tel: +381(0)290 385 500-11-20; +386(0) 49 757 411

hyson.shabanaj@lab-ks.org

Neni 1. LËNDA E KONTRATËS

IZHBK do të kryejë shërbimet e veta, trajnimin teorik dhe praktik për shërbimet në vijim, sipas ofertës së datës 08.07.2014 sipas çmimit të parajuar.

SHTOJCA 8.

Signing of agreement with IADK



Agreement with IADK



Unused/uncultivated Plot – Before Investment/Preparation



Selected Plot/Land Before Cultivation



Theoretical Classroom Training of Beneficiaries



Practical Outside Training of Beneficiaries



SHTOJCA 9.



MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM DHE MIRËKUPITIM

Lidhur më 28.10.2014 ndërmjet:

1. Sharrcem SH.P.K. - Hani i Elezit. Kompani private e regjistruar në Kosovë me Numër Biznesi: 70708396 me lokacion në Han të Elezit, përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues, Emmanouil Mitsou.

dhe

2. Sektori i Arsimit, Komuna e Hanit të Elezit. Përfaqësuar nga Drejtori, Irfan Qajani.

I

Në bazë të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet Sharrcem-it dhe Sektorit të Arsimit, Komuna e Hanit të Elezit;

Sharrcem dhe Sektori i Arsimit, Komuna e Hanit të Elezit pajtohen për bashkëpunim për projektin – **Aktivitetet Paralele**, ku Sharrcem do t'u ofrojë nxënësve të vitit të fundit të shkolles fillore (klasa e 9-të) kurse dhe trajnime për: Kompjuterë, Shëndet dhe Siguri dhe Mjedis.

II

Sektori i Arsimit, Komuna e Hanit të Elezit merr përsipër përgatitjen e listës së nxënësve dhe afatet kohore për projektin tonë – Aktivitetet Paralele, përkatësisht për kurse dhe trajnime.

III

Sektori i Arsimit, Komuna e Hanit të Elezit do të emërojë një të deleguar ndërlidhës si person përgjegjës për koordinimin me Zyrat e CSR-së në Sharrcem për të gjitha përgatitjet e nevojshme.

IV

Delegati ndërlidhës i emëruar nga Sektori i Arsimit, Komuna e Hanit të Elezit dhe nxënësi nga lista e cila do të ofrohet siç u cek më lart (neni II) do të jenë përgjegjës për bashkëpunimin me Zyrat e CSR-së në Sharrcem me qëllim të krijimit të kushteve për zbatim të suksesshëm të këtij projekti.

V


Sektori i Arsimit, Komuna e Hanit të Elezit do të jetë përgjegjës për mbajtjen e takimeve me nxënësit në përfundim të secilit kurs dhe të informojë Sharrcem-in me shkrim (përmes raportit), për mbarevajtjen.

VI

Sharrcem në mënyrë vullnetare do të mbështesë këtë projekt – Aktivitetet Paralele për nxënësit.



SHTOJCA 10.



Marrëveshje Për Donacion të Fondeve

Kjo Marrëveshje për Donacionin e Fondeve, në tekstin e mëtejshëm referuar si "**Marrëveshja**" është lidhur më 02.06.2014 nga dhe në mes të:

1. **Laboratori për Aktivitete të Biznesit**, një fondacion jo fitim-prurës, i regjistruar dhe që vepron në pajtim me Ligjet e Republikës së Kosovës, regjistruar në adresën Rruga Adem Jashari p.n. Hani i Elezit, përfaqësuar nga përfaqësuesi i tij i autorizuar z. Hysen Shabanaj, në tekstin e mëtejshëm referuar si "**LAB**"; dhe
2. **Sharrcem SH.P.K.**, ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar dhe që ushtron veprimtarinë sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 70708396 regjistruar në adresën Rruga Adem Jashari p.n. Hani i Elezit, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, z. Emmanouil Mitsou, Drejtor Menaxhues, në tekstin e mëtejshëm referuar si "**SharrCem**".

në tekstin e mëtejshëm referuar bashkërisht si "**Palët**".

Ndërsa:

1. SharrCem është njëri nga themeluesit e LAB;
2. LAB është themeluar me qëllim të lehtësimit të gjenierimit të punësimit në Kosovë duke i dhënë përparësi Hanit të Elezit përmes aktiviteteve për krijimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të NVM-ve dhe për avancimin e zhvillimit ekonomik të Hanit të Elezit dhe kudo tjetër në Kosovë;
3. Për qëllim e mbështetjes së aktiviteteve të LAB-it;
4. SharrCem zotohet të ndihmojë komunitetin e vet lokal përmes programit të Përgjegjësisë Sociale të Korporateve ("CSR").
5. SharrCem zotohet të mbështesë projektet synimi i të cilave është të përmirësojë dhe mbrojë mjedisin e komunitetit lokal.